

**VENDIM**  
**Nr.271, datë 6.4.2011**

**PËR VEPRIMTARINË AKADEMIKE, NË ZBATIMIN E PROGRAMIT TË FORMIMIT  
FILLESTAR DHE VAZHDUES, NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 47 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 15 të ligjit nr.8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Trupi pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës kryen veprimtari mësimdhënieje dhe mbështetëse, që i shërbejnë përmbushjes së misionit të saj për të siguruar formimin profesional të magjistratëve (gjyqtarë, prokurorë) dhe të operatorëve të tjerë të sistemit të drejtësisë, në rastet e parashikuara në ligj.

2. Trupi pedagogjik i Shkollës së Magjistraturës përbëhet nga pedagogë të brendshëm dhe pedagogë me kohë të pjesshme.

3. “Veprimtari mbështetëse”, në kuptim të këtij vendimi, konsiderohen veprimtaritë për hartimin e programeve të mësimi, hartimin e rregulloreve apo dokumentacioneve, përgatitjen e botimeve, moderimin e veprimtarive trajnuese, pjesëmarrjen në komisione *ad hoc*, si dhe veprimtari të tjera, të realizuara nga trupi pedagogjik.

4. Normimi i veprimtarisë mësimdhënëse dhe mbështetëse, për pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të Shkollës së Magjistraturës, bëhet nga këshilli drejtues.

5. Veprimtaria e mësimdhënies dhe ajo mbështetëse e pedagogëve me kohë të pjesshme konvertohet sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi. Për pedagogët të cilët kanë ushtruar, për një periudhë kohe jo më pak se 10 vjet, detyrën si gjyqtar, prokuror apo avokat, vlera e 1 ore mësimore 60-minutëshe është 1000 (një mijë) lekë.

6. Anëtarë të tjerë të trupit pedagogjik me kohë të pjesshme, që aktivizohen nga fusha të ndryshme, për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimore, të miratuara me aktet përkatëse, dhe për çdo orë mësimi të kryer, shpërblehen sipas kritereve të përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave që rregullon pagat për institucionet e arsimit të lartë.

7. Ora mësimore në Shkollën e Magjistraturës do të jetë 60 minuta dhe, për efekt të pagesës, do të konvertohet jo më pak se koeficienti më i lartë i konvertimit të orës mësimore në arsimin pasuniversitar, sipas legjislacionit të arsimit të lartë. “Orë mësimore”, në kuptim të këtij vendimi, konsiderohen si veprimtaria teorike, ashtu edhe ajo praktike.

8. Anëtarët e këshillit drejtues të shpërblehen në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se katër mbledhje në vit.

9. Anëtarët e jashtëm të këshillit pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës të shpërblehen në masën 8 000 (tetë mijë) lekë për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se dy mbledhje në vit.

10. Anëtarët e komisionit të provimit të pranimit në Shkollën e Magjistraturës, do të shpërblehen, sipas koeficientit, 1 (një) kandidat me 0.3-0.5 orë mësimore, e konvertuar në varësi të formës së provimit të pranimit.

11. Kandidatët për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës, me bursë të financuar nga Buxheti i Shtetit, përfitojnë dieta për udhëtim jashtë vendit, në masën 20 euro në ditë, për realizimin e një vizite studimore në Gjykatën e Strasburgut ose në një gjykatë tjetër të Bashkimit European. Në raste kur realizimi i vizitës përballohet nga donatorët ose pala pritëse, shpenzimet për dieta nuk përballohen nga fondet e planifikuara për Shkollën e Magjistraturës.

12. Me fondet e planifikuara për Shkollën e Magjistraturës, për vizitën studimore jashtë vendit, paguhen shpenzimet e transportit, vajtje jashtë shtetit e kthim, shpenzimet e transportit nga aeroporti në destinacion e anasjellas, si dhe shpenzimet e fjetjes. Për çdo rast, këto shpenzime njihen si të tilla sipas dokumentit përkatës (faturës, biletës etj.).

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për Shkollën e Magjistraturës.

14. Ngarkohet këshilli drejtues i Shkollës së Magjistraturës të nxjerrë udhëzime në zbatim të këtij vendimi.

15. Ngarkohet Shkolla e Magjistraturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**